



GSRM

SISTEMI ELEKTRONIK I PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE MBI LETRAT ME VLERË TË QEVERISË

Material Infomues

Ç'është GSRM

GSRM¹ (Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë) është një sistem elektronik ku publikohen të dhënat mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara çdo ditë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione qeveritare) nga subjektet e licencuara prej Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të operuar në këtë treg.

GSRM është ideuar dhe konceptuar nga AMF në formën e një platforme të përbashkët të shpërndarjes së informacionit nëpërmjet publikimit të detyrueshëm të të dhënave mbi veprimet e ekzekutuara nga operatorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Qëllimi i Futjes në Zbatim të GSRM

Qëllimi i futjes në zbatim të GSRM është për t'i ardhur në ndihmë publikut edhe investitorëve institucionalë, të cilët kanë investuar në letrat me vlerë të Qeverisë, të kenë një informacion më të plotë dhe në kohë reale mbi kërkesën dhe ofertën ditore për këto instrumente (bono thesari dhe obligacione qeveritare) në tregun me pakicë, i cili organizohet në sportelet e operatorëve të licencuar, kryesisht banka të nivelit të dytë.

Me futjen në zbatim të GSRM, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare synon rritjen e transparencës në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë duke siguruar një mbrojtje më të mirë të interesave të investitorëve.

Avantazhet e GSRM

GSRM sjell këto avantazhe:

- Rrit transparencën në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë;
- Krijon mundësinë e informimit të vazhdueshëm e në kohë reale të investitorëve;
- Rrit konkurrencën mes operatorëve në treg;
- Zvogëlon kostot operacionale të tregtimit në letra me vlerë të Qeverisë;
- Zvogëlon mundësinë e abuzimeve në treg;
- Krijon mundësi për një mbrojtje më të mirë dhe më efikase të investitorëve;

¹ Government Securities Retail Market – Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

- Krijon premisat për zhvillimin e mëtejshëm të tregut sekondar të letrave me vlerë.

Karakteri Publikues i të Dhënave në GSRM

Subjektet e licencuara për të operuar në tregun me pakicë janë të detyruara të publikojnë në GSRM të dhënat ditore mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara në letra me vlerë të Qeverisë, sipas afateve specifike të maturimit.

Kujdes: Të dhënat e publikuara në GSRM kanë vetëm karakter “informues” dhe jo “detyrues”. Kjo do të thotë që operatorët e licencuar nga AMF, ruajnë të drejtën për të negociuar me klientët e tyre në mbi çmimin, sasinë apo çdo të dhënë tjetër që ka lidhje transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë

Arkiva e të Dhënave

GSRM do përfshijë edhe një bazë të dhënash, e cila do u vijë në ndihmë personave të interesuar për të kërkuar në historikun e të dhënave të tregimit në letrave me vlerë të Qeverisë.